



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA**, na osnovu ovlašćenja datim članom 63 i 64 Zakona br.03/L-073 o opštim izborima u Republici Kosovo, na redovno održanom sastanku 26.06.2023, donosi:

### ODLUKA

#### O usvajanju Strateškog plana Centralne izborne komisije za 2023-2026.

- I. Usvaja se Strateški plan Centralne izborne komisije za 2023-2026.
- II. Plan kao u tački I, sastavni je deo ove odluke.
- III. Obavezuje se Sekretarijat CIK-a za sprovođenje ove odluke.
- IV. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Priština, 26.06.2023

**Predsedavajući**

**Centralna izborna komisija**

**Kreshnik Radoniqi**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



# Plani Strategjik i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2023-2026

Qershor, 2023

Përmbajtje

Mesazhi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	3
Lista e shkurtesave.....	4
Përkufizimet themelore .....	5
<b>1 Hyrje.....</b>	<b>6</b>
<b>2 Korniza ligjore dhe institucionale e KQZ .....</b>	<b>7</b>
2.1 Mandati dhe përbërja e KQZ.....	7
1.2. Baza ligjore e KQZ.....	7
1.3. Kompetencat e KQZ-së.....	7
1.4. Sekretariati i KQZ.....	8
1.5. Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike .....	8
1.6. Komisionet Komunale të Zgjedhjeve .....	8
<b>3 Procesi i planifikimit strategjik metodologjia.....</b>	<b>9</b>
3.1 Konsultimet e brendshme dhe të jashtme.....	9
3.2 Analiza SWOT .....	10
<b>4 Strategjia.....</b>	<b>11</b>
4.1 Vizioni.....	11
4.2 Misioni .....	11
4.3 Parimet orientuese.....	11
<b>5 Korniza strategjike .....</b>	<b>11</b>
<b>6 Implementimi i strategjisë, monitorimi dhe vlerësimi.....</b>	<b>27</b>

## Mesazhi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Historia e zgjedhjeve në Kosovë fillon në vitin 2000, kur më 28 tetor u mbajtën zgjedhjet e para për Kuvendet Komunale. Një vit më vonë dhe për herë të parë, u mbajtën zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

Deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, u mbajtën edhe disa procese të tjera zgjedhore, dhe pas këtij akti, organizimi i zgjedhjeve kaloi plotësisht te institucionet vendore: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, KQZ-ja ka arritur të organizojë dhjetëra procese zgjedhore, qoftë të pjesshme apo të plota, duke shënuar përparime të mëdha, të cilat janë vlerësuar edhe ndërkombëtarisht.

Po ashtu, organizimi i zgjedhjeve është një nga proceset më të mëdha dhe më gjithëpërfshirëse në një shtet. Kosova tashmë ka një traditë zgjedhore. Vëzhguesit e shumtë të zgjedhjeve, përfshirë edhe ata të Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve nga Bashkimi Europian kanë vlerësuar arritjet e KQZ-së në organizimin e zgjedhjeve, të cilat, në dekadën e fundit kanë qenë kryesisht të jashtëzakonshme, që duhej të mbaheshin brenda një periudhe të shkurtër kohore nga 30 deri 45 ditë.

Megjithëkëtë, institucionet që merren me organizimin e zgjedhjeve, ballafaqohen me sfida të shumta. Ballafaqimi me to dhe përgatitja për të ardhmen mund të arrihet përmes dokumenteve të qarta strategjike, zbatimi i të cilave kërkon angazhim të pandërprerë. Në këto qëllime është nisur puna për hartimin e këtij dokumenti, që përfshinë një periudhë katërvjeçare.

Plani Strategjik i KQZ-së, 2023-2026, është një dokument që në qendër ka Zgjedhjet. Në një sistem demokratik, mekanizmi kryesor që e mundëson shndërrimin e vullnetit të votuesve në strukturë qeverisëse janë zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe të administruara mirë. Prandaj, realizimi i të drejtës për të zgjedhur dhe të drejtës për t'u zgjedhur, është përkushtimi i të gjithëve që punojnë në KQZ.

Ky Plan Strategjik është një përmbledhje e përvojës së KQZ, i një varg analizash të hollësishme mbi proceset zgjedhore, i rekomandimeve të vëzhguesve ndërkombëtarë me vlerësime, sugjerime, kritika e propozime konkrete si Misioni i Vëzhgues i Bashkimit Evropian, Misioni Vëzhgues i Mbretërisë së Bashkuar, misionet vëzhguese të OSBE dhe i misioneve vëzhguese të organizatave jo-qeveritare vendore e ndërkombëtare.

KQZ shpreh falënderimin dhe mirënjohjen më të sinqertë për të gjithë akterët që me angazhimin dhe kontributin e tyre profesional, infrastrukturor, financiar kanë përkrahur në mënyrë të vazhdueshme dhe pa kushtëzime KQZ në të gjitha proceset zgjedhore dhe në punën e gjatë për hartimin e kësaj strategjie. Një falënderim i veçantë shpreh për Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Misionin e OSBE, Misionin vëzhgues të Mbretërisë së Bashkuar, organizatat jo-qeveritare vendore si dhe mediat.

## Lista e shkurtesave

A-WEB	Asociacioni i Zyrtarëve Botërorë Zgjedhor
BE	Bashkimi European
DAP	Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes
DOZ	Departamenti i Operacioneve Zgjedhore
DTI	Departamenti i Teknologjisë Informative
FPR	Formulari i Përputhjes së Rezultateve
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Këshilli i Vendvotimit
LV	Lista e Votuesve
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
ShV	Shërbimi Votues i KQZ
TMZ	Trupa për Menaxhimin e Zgjedhjeve
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VV	Vendvotim
ZFK	Zarfi i Fletëvotimit me Kusht
ZRCKFSP	Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike

## Përkufizimet themelore

Akterët	Të gjithë individët, grupet dhe organizatat që kanë interes të drejtpërdrejtë në sjelljen etike dhe operacionet e KQZ-së.
Akterët e brendshëm	Janë personeli i KQZ-së në zyrat qendrore dhe zyrtarët komunal.
Akterët e jashtëm	Janë partitë politike dhe kandidatët; institucionet e qeverisë, Kuvendi, PZAP, Sistemi Gjyqësor, monitoruesit dhe vëzhguesit e zgjedhjeve (vendorë dhe ndërkombëtarë), mediat, elektorati, organizatat e shoqërisë civile, komunitetet lokale dhe grupet minoritare, donatorët dhe ofruesit e asistencës zgjedhore.
Aktivitetet strategjike	Janë detyra specifike që kërkohen nga objektivi strategjik për të përmbushur synimet e veta të matshme.
Analiza Swot	Është një mjet i menaxhmentit, i cili synon të ballafaqojë përparësitë dhe mangësitë e organizatës, me mundësitë dhe kërcënimet e jashtme.
Deklarata e misionit	Përkufizon qëllimin e institucionit ; përshkruan se çfarë bënë KQZ-ja si institucion; kujt i shërben; pse i shërben; dhe si i shërben.
Deklarata e vizionit	Paraqet një pikëpamje ideale mbi atë se ku aspiron të jetë KQZ-ja në të ardhmen.
Objektivi strategjik	Është specifik, cak i matshëm që duhet të arrihet nga KQZ-ja për të realizuar çdo synim strategjik.
Parimet udhëheqëse	Vlerat dhe filozofia që karakterizojnë veprimet e KQZ-së dhe zyrtarëve të saj.
Treguesit e performancës	Janë një varg masash të miratuara të faktorëve të suksesit vendimtar që pasqyrojnë progresin drejt realizimit të një aktiviteti të caktuar.
Plani Operacional i KQZ-së	Një plan i hollësishëm i formuluar në nivel departamentesh të KQZ për të realizuar synimet e identifikuara strategjike.
Planifikimi strategjik	Është një metodologji e planifikimit sistematik për një periudhë të caktuar kohore e cila ndihmon menaxhimin efektiv të një procesi të realizimit të një qëllimi të caktuar.
Shtyllat strategjike	Sfera kyçe strategjike me përmbushjen e së cilës do të mundësohet realizimi i strategjisë së përgjithshme të organizatës.
Strategjia	Është një plan gjithëpërfshirës afatgjatë i krijuar për të realizuar një qëllim të caktuar.
Synimi strategjik	Ndryshimet që kërkohen për të lëvizur organizatën nga pika ku qëndron aktualisht (e tashmja) në pikën ku synohet të arrihet (e ardhmja).
Veprimet strategjike	Mund të definohen si: aktivitete të synuara në mënyrë efikase që duhet të implementohen me qëllim të arritjes së një synimi të caktuar.

## 1 Hyrje

Plani Strategjik i KQZ, 2023-2026, është një dokument, i ndarë në katër (4) pjesë, përmes së cilit qartësohet rruga që do të ndiqet nga KQZ si institucion që ka për detyrë organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës.

- ✓ Në pjesën e parë të këtij dokumenti prezantohet korniza ligjore dhe institucionale e KQZ, duke përfshirë edhe mandatin, kompetencat dhe përbërjen e përgjithshme të institucionit.
- ✓ Në pjesën e dytë, vëmendje i kushtohet procesit të planifikimit dhe hartimit të dokumentit strategjik, duke filluar nga metodologjia që është ndjekur dhe konsultimet me akterët e brendshëm e të jashtëm.
- ✓ Pjesa e tretë e dokumentit është pjesa kryesore e tij, pasi përveç përcaktimit të qartë të Misionit, Vizionit dhe Parimeve Orientuese të KQZ, janë përcaktuar 5 shtyllat strategjike; 25 synimet strategjike; 44 veprimet strategjike; 45 objektiva strategjike; 88 aktivitete strategjike; dhe 142 treguesit e zbatimit të tyre.
- ✓ Në pjesën e katërt, KQZ ka saktësuar se si do të bëhet zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i kësaj strategjie katërvjeçare.

Përmeshja e këtyre detyrave të përcaktuara në këtë dokument, do ta bëjë KQZ një institucion edhe më të qëndrueshëm, transparent, gjithëpërfshirës, shoqërisht të besueshëm dhe të paanshëm në procesin e organizimit dhe të administrimit të zgjedhjeve.

Zbatimi i plotë i legjislacionit për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale; përvetësimi i standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira; promovimi dhe pjesëmarrja e KQZ në ngjarjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me zgjedhjet; përfshirja e akterëve dhe hisedarëve në çdo fazë të administrimit të zgjedhjeve; rritja e transparencës dhe e besueshmërisë në integritetin e zgjedhjeve; rritja e pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje; modernizimi i shërbimeve – do të jenë thelbësore në orientimin strategjik të KQZ.

Ky dokument, është një listë me qindra detyra, zbatimi i të cilave do të ndihmojë KQZ, në procese zgjedhore, në përmeshjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për të cilat është themeluar.

## 2 Korniza ligjore dhe institucionale e KQZ

### 2.1 Mandati dhe përbërja e KQZ

KQZ është organ i përhershëm, i përcaktuar me nenin 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

KQZ përbëhet nga 11 anëtarë: Kryesuesi emërohet nga Presidenti, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli; 6 anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara; 1 anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë emërohen nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

### 1.2. Baza ligjore e KQZ

Funksionimi i KQZ-së mbështetet në këto ligje:

- *Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;*
- *Ligji Nr. 03/L-72 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës;*
- *Ligji Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike (2010);*
- *Ligji Nr. 04/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-174 (2011);*
- *Ligji nr. 08/L-122 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-058 dhe ligjin nr. 04/L-122 si dhe ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.03/L-256;*

KQZ ka plotësuar kornizën normative duke nxjerrë Rregulloret Zgjedhore, të cilat operacionalizojnë funksionalizojnë, sqarojnë dispozitat e ligjit dhe japin më shumë hollësi, se si të zbatohen ato në praktikë. Ato trajtojnë aspektet kryesore të procesit zgjedhor. Ndërkaq, me qëllim të rregullimit të mënyrës së brendshme të organizimit dhe funksionimit të KQZ, janë të miratuara 6 rregullore të brendshme.

### 1.3. Kompetencat e KQZ-së

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ, ndërsa me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale (LZL) në Republikën e Kosovës janë përcaktuar në mënyrë më të specifikuar këto përgjegjësi dhe funksionet e KQZ. Neni 64 i LZP-së përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ, si në vijim:

- Përgatitja dhe shpallja e rregullave, formave dhe procedurave zgjedhore, që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit për zgjedhje dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve, në kuadër të kompetencave të veta;
- publikimi i të gjitha rregullave të miratuara, rregullave, udhëzimeve dhe procedurave zgjedhore, duke i bërë ato të arritshme për opinionin;



- krijimi dhe mbajtja e listës së personave që kanë të drejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta;
- krijimi dhe funksionalizimi i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, paraparë me ligj;
- hartimi dhe miratimi i fletëvotimeve dhe materialeve të tjera zgjedhore;
- akreditimi i vëzhguesve të zgjedhjeve;
- krijimi, mirëmbajtja dhe certifikimi i Listës së Votuesve (LV) lidhur me zgjedhjet;
- numërimi, tabulimi dhe certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve;
- regjistrimi dhe certifikimi i subjekteve politike.

#### **1.4. Sekretariati i KQZ**

Sekretariati ndihmon KQZ në kryerjen e përgjegjësiave dhe funksioneve të tij, si dhe zbaton vendimet e KQZ. Po ashtu, Sekretariati përgatit raporte dhe rekomandime për vendimet e KQZ dhe siguron ndihmë tjetër të nevojshme administrative për KQZ.

#### **1.5. Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike**

Në pajtim me ligjin, KQZ ka themeluar ZRCKFSP. ZRCKFSP është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të subjekteve politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarim financiar të këtij ligji, si dhe monitorimin dhe kontrollimin e financave të subjekteve politike. Zyra e ka përgjegjësinë për hetimin e shkeljeve të ligjit, që t'i raportojnë ato pranë autoriteteve kompetente, kur kërkohet, dhe të shqiptojë gjoba.

#### **1.6. Komisionet Komunale të Zgjedhjeve**

KKZ janë trupa të themeluara nga KQZ, në tridhjetë e tetë (38) komuna të Republikës së Kosovës, për të ndihmuar në organizimin e zgjedhjeve. KKZ janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve brenda komunave, nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e KQZ, me qëllim të garantimit të ligshmërisë, legjitimitetit dhe efikasitetit të procesit zgjedhor.

### 3 Procesi i planifikimit strategjik metodologjia

Në muajin qershor të vitit 2022, KQZ ka nxjerrë vendim për formimin e grupit punues për hartimin e Strategjisë së KQZ për periudhën katër vjeçare 2023 – 2026. Ky grup punues është përbërë nga të gjithë anëtarët e KQZ si dhe nga zyrtarë të shumtë të Sekretariatit të KQZ. Puna intensive për hartimin e këtij dokumenti është zhvilluar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022.

Procesi i hartimit të strategjisë është mbështetur në udhërrëfyesin praktik për Organet e Menaxhimit të Zgjedhjeve për kryerjen e planifikimit strategjik.<sup>1</sup>

Për hartimin e këtij dokumenti, janë mbajtur disa takime dhe punëtori.

Në fillim, KQZ ka miratuar kalendarin e aktiviteteve për hartimin e planit strategjik.

Së dyti, KQZ ka bërë një vlerësim të zbatimit të strategjisë së kaluar, 2015 – 2018, për të parë se cilat nga aktivitetet mund të parashiheshin në planin e ri strategjik.

Së treti, KQZ ka përcaktuar qartë bazat strategjike (misioni; vizioni; parimet orientuese; shtyllat dhe synimet kryesore strategjike).

Së katërti, pas zhvillimit të draftkonceptit të dokumentit me bazat strategjike: misioni, vizioni, parimet orientuese, shtyllat dhe synimet kryesore strategjike, si dhe pas identifikimit të akterëve të brendshëm dhe të jashtëm, KQZ e ka përcjellë këtë draftkoncept tek akterët me qëllim të përfshirjes së ideve dhe komenteve të tyre në planin strategjik. Gjatë këtij procesi, KQZ inkuadroi palë të shumta të interesuara për zhvillimin e Strategjisë së KQZ për periudhën 2023-2026.

Së fundmi, KQZ ka rifilluar hartimin dhe përfundimin e dokumentit gjatë muajit janar 2023 dhe i njëjti është përfunduar gjatë muajit maj 2023.

#### 3.1 Konsultimet e brendshme dhe të jashtme

Për të siguruar sukses në procesin e planifikimit strategjik, si dhe për legjitimitet më të plotë, janë konsultuar akterët e brendshëm dhe të jashtëm. Ky konsultim është bërë gjatë fazës së hartimit të dokumentit. Konsultimi i akterëve të brendshëm dhe të jashtëm, konsiderohet si faktor i domosdoshëm në procesin e planifikimit strategjik.

Si akterë të brendshëm, grupi punues ka konsultuar personelin e KQZ në zyrën qendrore në Prishtinë, si dhe 38 Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve, nga çdo komunë e Republikës së Kosovës.

Për KQZ, përfshirja e akterëve të jashtëm në proces të konsultimit të hartimit të Strategjisë, siguron transparencën e institucionit dhe e bënë të mundur të marrë edhe këndvështrimet e ndryshme nga jashtë. Gjatë fazës së konsultimit të akterëve të jashtëm, dokumenti u është dërguar për komente: dy (2) institucioneve shtetërore, nëntëmbëdhjetë (19) organizatave jo-qeveritare dhe pesëdhjetë e një (51) partive politike.

Gjatë muajit nëntor, KQZ ka pranuar komente nga një institucion shtetëror (PZAP) dhe nga një OJQ (Roma Ashkalia).

---

[http://ifes.org/sites/default/files/strategic\\_planning\\_guide\\_2011\\_0.pdf](http://ifes.org/sites/default/files/strategic_planning_guide_2011_0.pdf)

### 3.2 Analiza SWOT

Përcaktimit të shtyllave, synimeve, veprimeve, objektivave dhe aktiviteteve strategjike i ka paraprirë analiza e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Këta faktorë, kanë ndikim në veprimtarinë e përgjithshme të KQZ. Po ashtu, për këtë qëllim, është marrë në konsideratë edhe përvoja e çmuar e KQZ në oranzimin dhe administrimin e zgjedhjeve.

FUQITË	DOBËSITË
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pavarësia institucionale;</li> <li>2. Publikimi i rezultateve preliminare të shpejta dhe të sakta;</li> <li>3. Statusi permanent dhe struktura gjithëpërfshirëse qendër dhe komuna;</li> <li>4. Kompetenca ligjore për nxjerrjen e rregullave;</li> <li>5. Profesionalizmi, përvoja dhe qëndrueshmëria e stafit në administrimin e zgjedhjeve;</li> <li>6. Hapja ndaj inovacionit dhe digjitalizimit të proceseve;</li> <li>7. Mundësimi për votim për të gjithë qytetarët me të drejtë vote (VJK, VPNV);</li> <li>8. Komunikimi me institucionet tjera dhe bashkëpunimi me subjektet politike;</li> <li>9. Kapaciteti operacional për organizimin e zgjedhjeve në afate të shkurta kohore;</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mungesa e hapësirave të nevojshme për punë;</li> <li>2. Zbrazëtirat ligjore;</li> <li>3. Integriteti i votimit jashtë Kosovës;</li> <li>4. Komunikimi dhe informimi jo i mjaftueshëm i publikut dhe mosazhurnimi i informatave në ueb faqe;</li> <li>5. Programi i pamjaftueshëm orientues për të gjithë stafin jo permanent;</li> <li>6. Marrja e pamjaftueshme e njohurive nga trajnimi tek stafi i KVV-së për procedurat e numërimit dhe paketimit;</li> <li>7. Mungesa e procedurave standarde për operacionet dhe aktivitetet zgjedhore;</li> <li>8. Komunikimi i brendshëm;</li> <li>9. Mungesa e masave dhe politikave për të siguruar pjesëmarrje së barabartë gjinore në stafin zgjedhor;</li> </ol>
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Reforma zgjedhore për adresimin e çështjeve të identifikuara;</li> <li>2. Përfitimi nga bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare me fushëveprim në zgjedhje;</li> <li>3. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile;</li> <li>4. Bashkëpunimi me organizatat menaxhuese zgjedhore të vendeve tjera;</li> <li>5. Përdorimi i teknologjisë dhe digjitalizimi i vazhdueshëm;</li> <li>6. Raportet e vëzhguesve të zgjedhjeve;</li> <li>7. Bashkëpunimi nga institucionet tjera;</li> <li>8. Fuqizimi i kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve të avancuara;</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mos përfundimi i reformës zgjedhore;</li> <li>2. Ekstrakti i regjistrit qendror civil me të dhëna jo të plota dhe të mangëta;</li> <li>3. Kërcënimet kibernetike;</li> <li>4. Tentim ndikim i disa kandidatëve të subjekteve politike tek anëtarët e KVV-ve për rezultatet e kandidatëve;</li> <li>5. Mospërfshirja në raportime e fushatave digjitale të subjekteve dhe kandidatëve;</li> </ol>

## 4 Strategjia

### 4.1 Vizioni

Për një institucion të qëndrueshëm, të besueshëm dhe inovativ, që fuqizon demokracinë përmes organizimit efikas të zgjedhjeve në përputhje me praktikën me të mira ndërkombëtare.

### 4.2 Misioni

KQZ është institucion i pavarur kushtetues që organizon zgjedhje dhe referendume, me standarde të larta ndërkombëtare, duke siguruar shprehjen e vullnetit të lirë të qytetarëve me të drejtë vote në Republikën e Kosovës.

### 4.3 Parimet orientuese

- **Ligjshmëria:** Të përmbushim funksionet dhe aktivitetet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore.
- **Pavarësia dhe paanshmëria:** Ushtrojmë përgjegjësitë tona në mënyrë të pavarur dhe te paanshme.
- **Transparenca dhe llogaridhënia:** Jemi të hapur dhe llogaridhënës në veprimet tona dhe sigurojmë qasje në informata.
- **Profesionalizmi dhe efikasiteti:** Angazhohemi për të kryer detyrat në mënyrë efikase dhe me profesionalizëm.
- **Gjithëpërfshirja dhe barazia:** Sigurojmë gjithëpërfshirje dhe mundësi të barabarta për secilin qytetar, pa dallime.
- **Inovacioni dhe përmirësimi i vazhdueshëm:** Në mënyrë të vazhdueshme rishikojmë aktivitetet dhe praktikën në funksion të ngritjes së efikasitetit dhe avancimit të procesit zgjedhor.
- **Integriteti dhe kredibiliteti:** KQZ siguron pacenueshmërinë e procesit zgjedhor duke rritur besueshmërinë dhe pranueshmërinë e zgjedhjeve.

## 5 Korniza strategjike

Sipas metodologjisë në të cilën është bazuar hartimi i kësaj strategjie, komponentët kryesorë të strategjisë së KQZ janë: shtyllat strategjike, synimet strategjike, veprimet strategjike, objektivat strategjike, aktivitetet strategjike dhe indikatorët e matshëm. Shtyllat strategjike të KQZ janë sfera kyçe strategjike me përmbushjen e të cilave do të mundësohet realizimi i strategjisë së përgjithshme të organizatës. Strategjia e KQZ përbëhet nga 8 shtylla strategjike, me përmbushjen e të cilave do të mundësohet realizimi i strategjisë së përgjithshme të KQZ.

Secila shtyllë strategjike e ka të paktën një synim strategjik dhe secili synim ka një apo më shumë veprime strategjike që realizohen përmes aktiviteteve strategjike, si pjesë e objektivave konkrete strategjike.

Plani Strategjik i KQZ për periudhën 2023-2026, përmban: 5 shtylla strategjike me 25 synime strategjike; 44 veprime strategjike; 45 objektiva strategjike; 88 aktivitete strategjike dhe 142 indikatorë.

<b>Plani Strategjik 2023 - 2026</b>	<b>Shtylla Strategjike 1</b>	<b>Shtylla Strategjike 2</b>	<b>Shtylla Strategjike 3</b>	<b>Shtylla Strategjike 4</b>	<b>Shtylla Strategjike 5</b>
<b>Synime strategjike</b>	6	1	8	5	5
<b>Veprime strategjike</b>	10	3	13	6	12
<b>Objektiva strategjike</b>	8	3	15	6	13
<b>Aktivitete strategjike</b>	26	4	24	13	21
<b>Indikatorët</b>	44	4	41	16	37

Shtylla Strategjike 1 - Qëndrueshmëria dhe fuqizimi institucional			
Planifikimi dhe qëndrueshmëria financiare	Sigurimi i kornizës buxhetore për implementimin e strategjisë.	Buxheti i KQZ-së të jetë në pajtim me strategjinë e KQZ-së	Planifikimi buxhetor dhe kërkesat janë në përputhje me aktivitetet në Planin Strategjik
	Përmirësimi i sistemit për zhvillim profesional të stafit dhe gjithpërfshirje.	Hartimi dhe implementimi i Planit për Zhvillim Profesional për stafin e KQZ-së	Buxheti i rishikuar përfshinë aktivitetet që fillojnë apo realizohen në 2023 sipas Planit Strategjik
Staf i trajnuar, profesional dhe gjithpërfshirës	Zhvillimi i programeve të trajnimeve	Ndarja e shumës prej së paku 1% të fondit vjetor të pagave për aktivitetet trajnuese.	Fondi për planin e trajnimeve është 1% e buxhetit vjetor për paga
		Stafi i KQZ-së të jetë në gjendje të përmbushë në mënyrë profesionale detyrat dhe përgjegjësitë	Regjistri i trajnimeve dhe aktiviteteve për ngritje profesionale i kompletuar de përditësuar. Numri i rekomandimeve të marra nga stafi për trajnimet Numri i stafit që është trajnuar
		Trajnimi i stafit të SKQZ-së në çështjet të menaxhimit të zgjedhjeve	Përmirësimi i performancës në menaxhimin e aktiviteteve zgjedhore dhe praktikave si rezultat i trajnimeve
			Programi i trajnimit i hartuar
		Trajnimi dhe burimet njerëzore hartojnë programe të trajnimit në bazë të nevojave dhe kërkesave të stafit.	Numri i trajnimeve të organizuara dhe përqindja e pjesëmarrjes Përmirësimi i performancës dhe praktikave si rezultat i trajnimeve

Strukturë organizative në pajtim me qëllimet dhe objektivat strategjike	Fuqizimi i strukturës organizative në pajtim me përgjegjësitë ligjore dhe qëllimet strategjike të KQZ-së	Sigurimi i strukturës efektive të burimeve njerëzore për përmbushjen e përgjegjësiave ligjore dhe Planit Strategjik	<p>Pjesëmarrje e anëtarëve të KQZ-së, stafit të KQZ-së në trajnime/aktivitete jashtë vendit, vizita studimore ose vëzhgime lidhur me menaxhimin e zgjedhjeve</p> <p>Mbajtja e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për vlerësimin e performancës së stafit.</p>	<p>Numri i anëtarëve të KQZ-së dhe stafit të KQZ-së që marrin pjesë në këto aktivitete jashtë vendit në krahasim me numrin e aktiviteteve të tilla të planifikuara.</p> <p>Raportet me rekomandime nga pjesëmarrja në aktivitete jashtë vendit</p> <p>Numri i punonjësve që marrin pjesë në trajnim dhe përfitojnë nga ky trajnim.</p> <p>Përshtypja/vlerësimi nga punonjësit që marrin pjesë në trajnim, për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e trajnimit</p> <p>Krijimi i mekanizmit efikas për vlerësimin e performancës së të gjithë të punësuarve në KQZ.</p>
		Organizimi i Zyrës për zbatimin e përgjegjësiave që dalin nga Ligji për	<p>Analizë e strukturës aktuale dhe vlerësimi i nevojës për rishikimin e strukturës organizative</p> <p>Shqyrtimi dhe aprovimi i strukturës organizative të rishikuar</p> <p>Plotësimi dhe ndryshimi i rregulloreve të brendshme të KQZ-së</p> <p>Hartimi dhe miratimi i strukturës organizative për ZRCKFSP</p>	<p>Analiza e përfunduar</p> <p>Numri i rekomandimeve të nxjerra nga analiza nga raporti i konsulentëve</p> <p>Struktura organizative e aprovuar nga KQZ</p> <p>Drafti i rregulloreve i hartuar</p> <p>Rregulloret e miratuara</p> <p>Drafti i rregulloreve i hartuar</p> <p>Rregulloret e miratuara</p>

	<p>Financimin e Subjekteve Politike</p>	<p>Caktimi dhe standardizimi i përgjegjësi të KKZ-ve dhe KVV-ve</p>	<p>Trupa zgjedhore (KKZ dhe KVV) kompetente, efektive dhe me përfaqësim gjinor</p>
<p>Analiza me funksionet që mund të realizohen në mënyrë efektive duke i deleguar në teren</p>	<p>Rishikimi i funksioneve të SKQZ-së dhe barja e aktiviteteve tek KKZ-të të cilat mund të menaxhohen në nivel komunal.</p>	<p>Zbatimi i standardizuar i kompetencave të KKZ-ve dhe KVV-ve në përputhje me ligjin dhe rregulloret.</p>	
<p>Rregulloret dhe procedurat me detyra dhe përgjegjësi të konkretizuara</p>	<p>Përcaktimi i qartë në rregullore dhe procedura i detyrave që janë përgjegjësi e KKZ-ve dhe KVV-ve.</p>		
<p>Përmbushja efektive e detyrave dhe përgjegjësi nga KKZ dhe KVV</p>	<p>Monitorim i implementimit të kompetencave të standardizuara dhe detyrave të KKZ-ve.</p>		
<p>Niveli i përmbushjes së detyrave të përcaktuara në planet e punës.</p>	<p>Organizimi i trajnimeve dhe pjesëmarrja në trajnime</p>		
<p>ZL.KZ-ve arritën të kuptojnë me sukses rregulloret e zgjedhjeve, sipas testit vlerësues pas trajnimit.</p>	<p>Trajnimi i ZL.KZ-ve për zbatimin e Rregulloreve të zgjedhjeve.</p>		
<p>Vlerësimi i njohurive të pjesëmarrësve para dhe pas trajnimit.</p>	<p>Trajnimi i KKZ-ve dhe stafit/ trajnerëve të terrenit SKQZ-së në teknikat e avancuara të trajnimit</p>	<p>Trajnimi i plotë i trupave menaxhuese zgjedhore</p>	
